

Index

Përmbledhje	3
Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë	
Strehimi Familjar	4
Analiza e disa faktorëve	5
Gjendja ekonomike	5
Profili gjeografik i varfërisë	6
Fenomeni-Fëmijët pa kujdes prindëror në Kosovë	8
Të gjeturat e studimit	
1. Kuadri ligjor i Shërbimeve të kujdesit social	9
2. Standardet e shërbimit social për fëmijët pa kujdes prindëror	11
3. Analiza e shkaqeve që nxisin fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror	12
3.1 Fenomeni i fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë	13
4. Institucionet e mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror	14
4.1 Detyrimet e Ministrisë	14
4.2 Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	17
4.3 QPS-të	18

5. Format themelore të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror	19
5.1 Gjendja aktuale e strehimit familjar në Kosovë	19
Aspekte kritike	22
Pas strehimit, adoptimi	24
Konkludimet	26
Rekomandimet	28
Lista e Akronimeve dhe bibliografia	31

PËRMBLEDHJE

Amici dei Bambini, që vepron në partnership me ministrinë e Mirëqenies Sociale, të Edukimit dhe të Shëndetit të Kosovës, është e pranishme në Kosovë që nga viti 1999 ku vepron edhe sot e kësaj dite. Objektivi i saj është mbështetja e sistemit të mbrojtjes së të miturve jashtë familjes, duke sjellë ndihma konkrete, njohuri, kompetenca dhe mjete pune nga përvoja e vet ndërkombëtare dhe duke promovuar proceset e bashkëndarjes mes vepruesve të ndryshëm të sistemit.

Ky botim, fryt i një pune ekipore shumëdisiplinore, bën pjesë në kuadrin e projektit trevjeçar në Kosovë AID9697 **“Forcimi i shërbimeve në favor të të miturve nën përgjegjësi të Qendrave për Punë Sociale të Kosovës për motive familjare”**, i bashkëfinancuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe në mënyrë specifike synon zhvillimin e shërbimeve sociale kosovare që merren me fëmijët jashtë familjes, me një vëmendje të veçantë tek fëmijët në strehim jashtë dhe brenda familjes.

Prandaj ndër veprimet e para të projektit, është vlerësuar i nevojshëm përcaktimi i një tabloje të përditësuar të sistemit të strehimit i pranishëm sot në Kosovë, sinteza e të cilit paraqitet në faqet në vijim.

Për hartimin e këtij studimi bazë, është analizuar sistemi kompleks i ligjeve dhe drejtimeve administrative që rregullojnë sistemin e strehimit dhe janë mbledhur të dhënat më të fundit dhe studimet ndërkombëtare mbi temën e strehimit në Kosovë, duke i kushtuar vëmendje të gjithë atyre elementëve që lejojnë dallimin e shkaqeve të braktisjes dhe të largimeve familjare, si dhe përgjigjet përkatëse të sistemit të mirëqenies sociale.

Ky botim nuk ka pretendimin të jetë i plotë dhe i mjaftueshëm, por përpiqet të japë një panoramë të implantit normativ, të standardeve dhe të mënyrës së përcaktimit të shërbimeve sociale, mbi rolin e monitorimit të vetë Ministrisë së Mirëqenies Sociale në kuadër të decentralizimit administrativ.

Mara Bernasconi

Project Coordinator

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë

Strehimi Familjar

Ky studim ka për qëllim të identifikojë çështjet më kritike që kanë të bëjnë me sistemin e mbrojtjes sociale të fëmijëve pa kujdes prindëror me synimin që të hartohen rekomandime efektive që do të nxisin përmirësimin dhe zhvillimin e praktikave të mira rreth përkujdesjes së fëmijëve pa kujdes prindëror e sidomos atyre praktikave që i referohen **strehimit familjar** si përgjigje e **përkohshme** ndaj këtij **problemi**

Objektivat e Studimit:

- ❖ të identifikojë shkaqet thelbësore që nxisin fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror;
- ❖ të përshkruajë kuadrin ligjor që trajton fëmijët pa kujdes prindëror;
- ❖ të përshkruajë dhe të vlerësojë standardet e shërbimit social për fëmijët pa kujdes prindëror;
- ❖ të identifikojë institucionet dhe burimet në dispozicion për përkujdesje sociale për fëmijët pa kujdes prindëror;
- ❖ të identifikojë praktikat aktuale të punës sociale të cilat praktikohen gjatë trajtimit të fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar;
- ❖ të identifikojë çështjet kritike rreth decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare

Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi janë analizuar politikat, legjislacioni, publikime dhe të dhënat statistikore të mbledhura nga baza e të dhënave në DMS-MPMS. Gjithashtu janë marrë në shqyrtim edhe përvojat dhe tregimet e punonjësve socialë nga rastet konkrete të fëmijëve pa kujdes prindëror të vendosur në strehim familjar.

ANALIZA E DISA FAKTORËVE

Gjendja ekonomike

Të dhënat dhe ilustrimet në vijim që ndërlidhen me gjendjen ekonomike dhe varfërinë në Kosovë mbështeten në kuadër të qëllimeve të këtij punimi, i cili synon që t'i ofrojë lexuesit një pasqyrë të përgjithshme. Këtu nuk jemi për të përshkruar në thellësi gjendjen ekonomike në Kosovë, por për të ofruar një kornizë referimi në të cilën mund të marrim në konsideratë çdo gjë të shprehur me lart, pasi varfëria e shumicës së popullsisë ndikon vendosmërisht në zbatueshmërinë e të drejtave të qytetarisë.

Në bazë të raportit “Economic Report Kosovo 2012”- Ekonomia e Kosovës nuk është një ekonomi konkurruese, as nuk ka infrastrukturën e nevojshme për të tërhequr investitorët e huaj. Vuan gjithashtu nga pamjaftueshmëria e institucioneve, ka një sistem të paplotë juridik dhe gjyqësor, dhe nuk është në gjendje të krijojë vende pune për popullatën e re shumicë. Sektori i energjisë është në vështirësi dhe mungesat e infrastrukturës së përshtatshme të transportit e bëjnë të kushtueshëm prodhimin dhe tregtinë, duke penguar zhvillimin e prodhimit industrial dhe përbëjnë një pengesë për investimet në përgjithësi.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka Botërore dhe Zyra e Statistikave të Kosovës rezulton se: “Kosova mbetet vendi më i varfër në Evropën Jug-Lindore. Në vitin 2009 BPV-ja e Kosovës për kokë banori prej 1,760 € (Eorld Bank 2010) është më e ulëta në EJT sipas marginës së gjërë dhe e vendos atë si një nga vendet më të varfra në mbarë Evropën. Përmirësimi i tablosë së punësimit është çështje kyçe në zvogëlimin e varfërisë dhe në ngritjen e standardeve jetësore përmes një rritje më të shpejtë dhe më përfshirëse. Shkalla papunësisë së Kosovës, sipas Sondazhit të Fuqisë Punëtore (Enti Statistikor i Kosovës 2010) në vitin 2009 vlerësohet të jetë 46 për qind kurse 48 për qind sipas një Memorandumi Ekonomik të Vendi të zhvilluar së fundmi nga Banka Botërore (Eorld Bank 2010). Shkalla e punësimit është vetëm 26 për qind (Eorld Bank 2010). Krijimi i vendeve të punës është edhe më i rëndësishëm sepse popullata e Kosovës është më e re në krahasim me vendet e tjera në rajon. Afërsisht gjysma e popullsisë së Kosovës është më e re se 24 vjeçare dhe vetëm 6 për qind e popullatës është më e vjetër se 65 vjeç.”

Sipas të njëjtave burime, “në vitin 2009 pak më shumë se një e treta e popullsisë (34 për qind) jetonte nën pragun e varfërisë absolute prej 1.55 € për një person të rritur në ekuivalente ditore, dhe 12 për qind jetonte nën vijën e varfërisë së skajshme prej 1.02 €.” Zbrazëtia e treguesit të varfërisë ishte 9.6, që tregon se mesatarisht një person në Kosovë realizon vetëm 72 për qind të linjës së varfërisë. Linjat e varfërisë në zonat rurale dhe urbane janë pothuajse të barabarta por dallojnë shumë përgjatë shtatë rajoneve të Kosovës. Në raportet më të fundit të Bankës Botërore mbi vlerësimin e varfërisë, niveli i varfërisë absolute në konsum është në masë të konsiderueshme më i ulët sesa është raportuar nga SBF-ja.

Në vijim të këtij punimi paraqesim të dhënat tabelare mbi profilin gjeografik të varfërisë pasi ky dimension i hulumtimit është me interes për zbardhjen dhe sqarimin e disa segmenteve të dukurisë së fëmijëve pa kujdes prindëror.

Profili gjeografik i varfërisë

Tabela 1: Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas rajonit, 2009

Linja e varfërisë së plotë

Linja e varfërisë së skajshme

Rajoni	Për person	Zbrazëtira e varfërisë	Për person	Zbrazëtira e varfërisë
Ferizaji	53.8	14.6	17.7	3.7
Gjakova	54.0	16.3	22.4	5.9
Gjilani	18.0	3.8	3.6	0.9
Mitrovica	38.0	12.2	17.0	4.2
Peja	37.2	10.9	13.1	3.8
Prishtina	21.8	6.2	9.0	1.3
Prizreni	33.9	7.6	6.8	1.0
Gjithsej	34.5	9.6	12.1	2.7

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Tabela 2: Shpërndarja e të varfërve, 2009

Zona/Rajoni	Shpërndarja e Popullatës	Shpërndarja e të varfërve	Shpërndarja e varfërisë së skajshme
Urbane	49.3	35.6	39.8
Rurale	50.3	64.4	60.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
Ferizaji	20.0	17.1	16.0
Gjakova	19.6	17.3	20.4
Gjilani	6.8	5.8	3.3
Mitrovica	15.3	16.8	21.4
Peja	14.0	11.1	11.0
Prishtina	10.6	15.9	18.7
Prizreni	13.8	16.0	9.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

FENOMENI

Fëmijët pa kujdes prindëror në Kosovë

Nga një studim i fundit i Unicef (John Hard, Better Childhood, Unicef 2012), profili demografik i Kosovës evidenton një popullatë të re, me pothuaj 30% nën moshën 15 vjeçare. Për sa i përket përbërjes etnike, raporti i lindjeve është pak a shumë i njëjti për pjesën më të madhe të popullsisë dhe të grupeve etnike minoritarë dhe dëshmohet mbi 2.4 për grua N-Fertile (Banka Botërore 2012). Më shumë se 60% të popullsisë banon në zona rurale dhe është shpërpjesëtuar në bazë të ardhurave: 81% e të varfërve në Kosovë jetojnë në zona rurale. Në përgjithësi, pothuaj 40% e të gjithë kosovarëve jetojnë me më pak se 2.50 dollarë në ditë. Në këtë kuadër varfërie dhe të lindshmërisë së lartë futen familjet biologjike që nuk arrijnë të kujdesen për fëmijët e tyre, që vuajnë nga probleme mendore apo që janë në kujdestarinë e QPS-ve dhe të cilave u njihet një shifër mujore e ndihmës sociale.

Sipas Raportit Vjetor të Ministrisë së Mirëqenies, mesatarisht 170 fëmijëve pa kujdes prindëror, çdo vit u ofrohet strehim në sistemin e mirëqenies sociale: strehim familjar jashtë familjes biologjike dhe strehim rezidencial (Raporti vjetor 2008, 2009, 2010). Ndërsa në strehim familjar tek farefisi aktualisht gjenden 600 fëmijë pa kujdes prindëror.

Sipas të dhënave në Data Bazën e Shërbimeve Sociale në DMS/ MPMS, numri i përgjithshëm i fëmijëve të vënë nën kujdestari në vitin 2012 është 1.135, duke përfshirë të gjithë fëmijët që janë: të braktisur, prindërit e të cilëve nuk janë gjallë, jetimë të luftës, me prindër të panjohur ose të zhdukur, apo me prindër që për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror, etj.

Administrimi i gjendjeve komplekse dhe delikate që kanë për objekt fëmijën nënkupton një marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi midis Komunave, të vetme ose të shoqërizuara, QPS si institucion për mbrojtjen e fëmijëve dhe Autoriteteve Gjyqësore, por edhe me Shkollat dhe Organizatat Shëndetësore që mund të bashkëpunojnë me drejtësinë, nëse thirren në çështje.

Sipas Raportit Vjetor 2011 të MPMS/DSM, në strehim familjar, kanë qenë 99 fëmijë pa kujdes prindëror (67 fëmijë të braktisur, dhe 32 fëmijë të lënë pas dore), për të cilët QPS-të kanë punuar për zgjidhjen e statusit të

tyre juridik dhe gjetjen e formës së mbrojtjes afatgjatë: bashkimin familjar me familjen biologjike apo adoptim.

Aktualisht ka fëmijë pa status të zgjidhur, nuk kanë një status juridik të përcaktuar e që janë në strehim familjar jashtë familjes, për një periudhë që shkon përtej 2 viteve, për shkak të zgjatjes së procesit gjyqësor apo për arsye tjera.

Familjet biologjike nga të cilat fëmijët largohen nga kujdesi prindëror për shkak të lënies pas dore apo ndonjë arsye tjetër sipas raporteve të shërbimeve sociale, nuk kanë mundësi ribashkimi, por mbeten megjithatë bartës të përgjegjësisë prindërore për çështje procedurale të lidhura me gjykatat. Pra, këta fëmijë mbeten në një “boshllëk ligjor” pa mundur të përcaktohet plotësisht statusi i tyre si fëmijë të birësueshëm. Duke qenë një sistem sinjalizimi i rasteve të rritjes së pakontrolluar të dekadencës së autoritetit prindëror, në fakt, dhe duke qenë nga ana e operatorëve të shërbimeve frika në lidhje me sigurinë e tyre në momentin në të cilin propozojnë ndërprerjen e autoritetit prindëror dhe duke mos ekzistuar deri sot në Gjykatën e Shkallës së parë një seksion aktualisht aktiv për fëmijët, sistemi gjyqësor i mbrojtjes së fëmijëve rezulton i ngathtë.

Të gjeturat e studimit

1. Kuadri ligjor i Shërbimeve të kujdesit social

❖ Ligji Nr. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës

Ligji Nr. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës - rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Përmes këtij ligji Neni 7. Forma e mbrojtjes, pika 2. “Fëmijëve pa kujdes prindëror u sigurohet mbrojtja e posaçme përmes formave të mbrojtjes siç janë :

- ✓ kujdestaria,
- ✓ strehimi familjar,
- ✓ strehimi rezidencial
- ✓ adoptimi

Ligji Nr. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës, afirmon përkujdesjen alternative për fëmijët pa kujdes prindëror - Strehimin familjar, por njëkohësisht e precizon përkohshmërinë e kësaj forme të mbrojtjes juridiko-sociale duke udhëzuar që të ndërmerren të gjitha masat e punës sociale për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të fëmijës. Kurse mbështetja financiare e **strehimit familjar mbështetet në Nenin 5, pika.1** : “Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata me çrregullime mendore ose fizike të diagnostikuara, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, **janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore**”.

- ❖ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17
- ✓ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 përcakton dhe rregullon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të sistemit të mirëqenies sociale siç janë: 1.Ministria, 2.Departamenti përkatës, 3.Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, 4.Komuna dhe 5.Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe Sektori Joqeveritar, në “ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë”
- ✓ Mbështetë politikat e decentralizimit të shërbimeve sociale nga niveli qendror në nivel të qeverive lokal – i udhëhequr nga parimi i politikave moderne: **shërbimet sa më afër qytetarit**;
- ✓ Përcakton dhe precizon hierarkinë e renditjes dhe nënrenditjes, subordinimit të institucioneve përbrenda sistemit të mirëqenies sociale;
- ✓ Ligjëson dhe përcakton prioritetet në politikat e deinstitutionalizimit - neni. 1, pika 1.2;
- ✓ Afirmon dhe përforcon punën sociale në komunitet - neni. 1, pika 1.2;
- ✓ Specifikon listën e përfituesve nga shërbimet sociale dhe familjare;
- ✓ Brendëson në veti parimet dhe të drejtat e fëmijëve të precizuar me KDF;
- ✓ Specifikon rolin e organit të kujdestarisë për fëmijët pa kujdes prindëror;
- ✓ Afirmon format alternative të përkujdesjes për fëmijët pa kujdes prindëror dhe specifikon kushtet në të cilat një fëmijë mund të vendoset në strehim familjar;
- ✓ Përcakton rolin e QPS-ve në vendimmarrjen që i referohet strehimit familjar;

- ✓ Përcakton detyrat dhe rolin e Panelit për Adoptim dhe Strehim Familjar. Kjo sferë është e rregulluar edhe me: Udhëzimin Administrativ nr. 12/2012 për Përbërjen dhe Funksonimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve në Strehim Familjar dhe Adoptim;
 - ✓ Nxitë aplikimin e metodologjisë së avancuar të punës sociale në organizimin e punës sociale në raste: Menaxhimi i rastit si dhe puna në partneritet me të ndërlidhurit;
 - ✓ Njeh OJQ-të si entitete të pavarur dhe ligjëson bashkëpunimin me OJQ.
- ❖ Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare-në mënyrë taksative rregullon dhe precizon bazën ligjore të ndërtimit të sistemit rregullator të shërbimit social-Inspektimi, monitorimi, licencimi dhe standardizimi i shërbimeve sociale.

2. Standardet e shërbimit social për fëmijët pa kujdes prindëror

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 dhe Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare përbëjnë bazën themelore për ndërtimin e sistemit rregullator të shërbimeve sociale dhe familjare. Me iniciativë të DMS - MPMS ka filluar procesi i vendosjes së bazave të këtij sistemi përmes standardizimit të shërbimeve sociale që për qëllim ka: ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të përshtatshme në nivel komunal për nevojat e individëve në gjendje të nevojës sociale për këto shërbime. Në vitin 2011 në mbështetje të Zyrës së Komisionit Evropian në Prishtinë, DMS-MPMS ka standardizuar 5 (pese) shërbime sociale dhe familjare: 1.Dhuna në familje, 2.Puna e fëmijëve, 3.Adoptimi i fëmijëve pa kujdes prindëror, 4.Besimi i fëmijëve të prindërve të ndarë dhe 5.Kujdesi institucional për persona të moshuar. Ky proces i standardizimit të shërbimeve sociale dhe familjare do të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2012 me 5 (pesë) standarde të reja.

3. Analiza e shkaqeve që nxisin fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror

- ❖ Fenomeni i fëmijëve pa kujdes prindëror i parë nën dritën e dimensionit historik, është i vjetër sa vetë njerëzimi - pra është një fenomen social i pranishëm në të gjitha shoqëritë njerëzore pavarësisht stadi dhe nivelit të zhvillimit të këtyre shoqërive. Në këtë kontekst për një studim më të thellë dhe të gjithanshëm do të rekomandohej: studimi i formave të reagimit të shoqërisë kundrejt nevojave të fëmijëve pa kujdes prindëror. Në përputhje me objektivat e tij, studimi në vijim do të përqendrohet në shkaqet e përgjithshme që kushtëzojnë problemet sociale të kësaj natyre, në fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror si dhe do të bëjë përpjekje të pasqyrojë brenda mundësive, në mënyrë specifike disa prej shkaqeve aktuale dhe të drejtpërdrejta që e nxisin këtë fenomen në Kosovë.
- ❖ Shkaqet e përgjithshme që në mënyrë direkte/indirekte mund të nxisin fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror mund të grupohen në 4 (katër) grupe të mëdha.
- ❖ Sistemet e ndryshme politike dhe socio-ekonomike dhe niveli i zhvillimit të tyre: a) shpërndarja e pabarabartë e të mirave materiale në shoqëri, shkalla e lartë e papunësisë, shkallë e lartë e varfërisë, punësimi i përkohshëm, të ardhurat minimale individuale, qasja në arsim dhe pamundësia e arsimimit, migrimi dhe imigrimi; b) patologjitë familjare, dhuna në familje, shkurorëzimet, lënia pas dore e fëmijëve nga ana e prindërve; çorganizimi i mezo dhe makrosistemeve sociale etj.
- ❖ Aspekti shëndetësor: a) çrregullime të funksioneve vitale tek individit para dhe pas lindjes: sëmundjet mendore dhe fizike, ngecjet në zhvillim mendor dhe të kombinuara.
- ❖ Aspekte të sjelljes: varësia nga substancat narkotike, kriminaliteti dhe delikuenca e të miturve, trafikimi, prostitucioni, bredhja, ikja nga shtëpia, lypsarija dhe sjelljet e tjera asociale.
- ❖ Konfliktet dhe katastrofat natyrore: luftërat, tërmetet, vërshimet dhe epidemitë e ndryshme.

Në grupimet e më sipërme janë përmendur një numër shkaqesh që mund të nxisin fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror por nuk kufizohen vetëm në këtë fenomen. Shkaqet e sipërpërmendura në varësi të kontekstit dhe rrethanave mund të identifikohen edhe si pasoja – për këtë arsye ato duhet parë vetëm në kontekstin e rrethanave reale të veprimit si faktor nxitës.

3.1 Fenomeni i fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë – Shkaqet e drejtpërdrejta të identifikuara në praktikën aktuale të punës sociale

Edhe Kosova nuk bën ndonjë përjashtim sa i përket pranisë së dukurisë së fëmijëve pa kujdes prindëror – dhe nuk është immune nga ndikimi i faktorëve të sipërpërmendur sikurse të gjitha shoqëritë njerëzore aktuale. Nëse flasim në mënyrë specifike për fenomenin, shtrirjen dhe shpeshësinë e tij, mund të konstatojmë me një siguri shumë të madhe duke u bazuar në të dhënat statistikore se rrethanat e krijuara para, gjatë, dhe pas Luftës së Kosovës më 1998/99 kanë kushtëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë duke nxitur dhe fuqizuar edhe faktorët e tjerë pasivë - në rritjen e numrit të fëmijëve pa kujdes prindëror.

Në vijim do të listojmë një grup të shkaqeve të drejtpërdrejta që ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë të hasura në praktikën e punës sociale

- ✓ **Shkatërrimi i programuar** dhe sistematik i të mirave materiale dhe njerëzore para dhe gjatë luftës së vitit 1998/99 - ku për pasojë kanë mbetur shumë fëmijë pa kujdes prindëror - jetimët e luftës
- ✓ **Dhunimet gjatë luftës dhe shtatëzanitë e padëshiruara;**
- ✓ **Shtatëzanitë e padëshiruara** tek adoleshentët - kushtëzuar nga një liberalizim i konceptit të praktikimit të seksit para martesë i pa përcjellë nga një edukim seksual në sistemin edukativ shkollor si dhe nga mungesa e komunikimit brenda familjes për marrëdhëniet seksuale si një temë ende tabu e sidomos në mes konservatorëve - tek komunitetet fetare dhe mjedise rurale
- ✓ **Shtatëzanitë e padëshiruara tek Viktimat e trafikimit** dhe punëtorët e seksit (prostitutat)
- ✓ **Shtatëzanitë e padëshiruara / apo lindja e përsëritshme** e fëmijëve të gjinisë femërore që për disa bashkëshortë ka qenë e pa pranueshme;
- ✓ **Shkurorëzimet** bashkëshortore për arsye të ndryshme: a) tradhtia bashkëshortore - dyshimet mbi atësinë, b) migrimi në botën e jashtme për shkaqe punësimi që kanë rezultuar me martesë të reja në vendet migruese dhe shkurorëzime; c) vrasja e bashkëshortes/bashkëshortit - vuajtjet e dënimeve me burg, c) dhuna në familje etj.

- ✓ **Vdekja e njërit prind dhe rimartesa e prindit tjetër;**
- ✓ **Gjendjet e rënda shëndetësore** të prindërve tek të cilët pushojnë kapacitetet (aftësitë) për të ushtruar kujdesin prindëror për fëmijët;
- ✓ **Gatishmëri jo e mjaftueshme e prindërve për përkujdesje** për fëmijët me aftësi të kufizuar - sidomos për ato raste kur dëmtimet fizike dhe mendore janë të rënda dhe kërkohet trajtim i specializuar.

4. Institucionet e mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror

Shtetit i takon përgjegjësia e mbrojtjes së të miturve pa kujdes prindëror dhe këtë e realizon nëpërmjet institucioneve të Mirëqenies Sociale – Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale -Departamenti përkatës, Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe QPS-të.

4.1 Detyrimet e Ministrisë

Në bazë të Rregullores 02/2011, Ministria ka detyrimin për:

- I. të zhvilluar punën dhe politikat sociale dhe projektet për të zbatuar normativat në këta sektorë;
- II. të mbështetë dhe promovuar marrëdhëniet e punës jo diskriminuese dhe punësimin, duke mbajtur parasysh normat përkatëse ndërkombëtare të punës;
- III. të monitorojë punësimin dhe mirëqenien sociale dhe të propozoj masa aktive e të përshtatshme për të rritur punësimin dhe për të ulur papunësinë dhe masa të duhura për të përmbushur nevojat shoqërore të ndihmës sociale për qytetarët në vështirësi;
- IV. të mbështesë politikat e veprimit dhe praktikat e punës së mirëqenies shoqërore për të mbrojtur familjet dhe të miturit;
- V. të vendos norma për sigurimin dhe kujdestarinë në punë dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
- VI. të administroj dhe mbikëqyrë institucionet publike administrative të punës dhe të përkrahjes sociale dhe të bashkëpunoj me Komunitat, zyrtat sociale dhe institucione tjera të përfshira në realizimin e punës dhe politikave sociale;

- VII. të mbikëqyrë oferta dhe kërkesa si tregues të punës dhe të përshtatë masa të harmonizimit;
- VIII. të zhvilloj dhe mbikëqyrë programe të formimit profesional për personat e papunë dhe në kërkim të punës, me qëllim të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe të përmirësoj mundësinë e tyre të punësimit;
- IX. të promovoj dhe inkurajoj dialogun shoqëror midis palëve sociale (organizata të punëtorëve, sindikata, organizata të punëdhënësve dhe Qeverisë);
- X. të thirrë mbledhjen e Këshillit ekonomik dhe social, si organi më i lartë këshillimor i palëve shoqërore në lidhje me punësimin, politikat sociale me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve sociale, dhe të përfaqësoj qeverinë e Kosovës në këtë organizim;
- XI. të ofroi asistencë financiare me fonde të përcaktuara për familjet dhe personat që kanë nevojë;
- XII. të administroj përdorimin dhe zhvillimin e infrastrukturës lidhur me mirëqenien sociale dhe të punës në harkun e zbatimit të përgjegjësisë të kësaj Ministrie;
- XIII. të administroj dhe mbështetë zhvillimin e një sistemi sigurimi social, përfshirë pensionet dhe shërbimet e papunësisë;
- XIV. të ofroi mbështetje emergjente financiare dhe sociale dhe mbështetje të përhershme nëpërmjet institucioneve të krijuara për këtë qëllim për qytetarët në vështirësi.

Brenda Ministrisë së Mirëqenies veprojnë Departamente të ndryshme. Departamenti i Mirëqenies Sociale është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në nevojë sociale.

Ky i fundit është formuar më 3 mars 2000. Ky repart Departament është përgjegjës për çështjet e përgjithshme të administrimit dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Nga viti 2004 struktura organizative e Departamentit ka pësuar ndryshime dhe sot formohet nga Divizione të veçanta; për sa i përket të miturve jashtë familjes i referohemi Divizionit për Shërbimet Sociale.

Misioni i Departamentit të Mirëqenies është përpjekja për zhvillimin e një legjislacioni të ri, duke përcaktuar norma dhe shërbime të mbrojtjes sociale për mbështetje të grupeve të pambrojtura, përfshirë kriteret legjitime dhe transparente.

Me decentralizimin në veprim, misioni i Departamentit mbetet zbatimi dhe zhvillimi i politikave sociale dhe kujdestarisë (mbrojtjes) së kategorive të ndryshme të qytetarëve në nevojë, me vëmendje të veçantë për:

- zhvillimin e shërbimeve sociale në përputhje me nevojat e grupeve të ndryshme (fëmijë të braktisur, viktimat të trajtimit, viktimat të dhunës në familje, viktimat të abuzimeve mbi të miturit, raste sëmundjeje, gra, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, të riatdhesuar, etj.);
- zbatimin e të drejtës sociale dhe ndryshimin e kriterëve për të destinuarit e asistencës sociale me qëllim për të arritur tek më të varfrit;
- zhvillimin e infrastrukturës sociale dhe vendbanime të përkohshme për grupet e ndryshme të përfshira në situata emergjente dhe zhvillimin e një rrjeti komunitetesh të bazuar mbi shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara;
- ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë banorët e Kosovës (me shërbimet sociale, pagesën nëpërmjet QPS dhe Komunave pa asnjë diskriminim);
- zhvillimin e një sistemi informues, sistem komunikimi, monitorimi, transparence, efikasiteti dhe një kontroll më të mirë të realizimeve sociale dhe mbrojtjes sociale;
- zhvillimin e personelit administrativ profesional të mjaftueshëm për të gjitha institucionet e DMS.

Qëllim parësor i DSM është lufta kundër varfërisë, dhënia e shërbimeve të ndryshme sociale dhe asistencës institucionale për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, për të gjithë banorët e Kosovës, pavarësisht nga etnia dhe besimi i tyre.

Objektivat kryesore dhe prioritetet e DSM, në përfundim të procesit të decentralizimit do të orientohen drejt monitorimit dhe përcaktimit të standardeve të shërbimeve në këtë mënyrë:

- mbështetje për grupe shoqërore të pambrojtura, ulja e varfërisë dhe dhënia e shërbimeve të ndryshme sociale, për të gjithë banorët e Kosovës, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë dhe besimit fetar;
- zhvillimi i politikave të reja sociale mbi bazën e gjendjes aktuale në Kosovë dhe standardeve të mbrojtjes sociale;
- përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe zhvillimi i strategjisë, politikës, normave për shërbimet sociale në Kosovë;

- bashkëpunim më i madh midis institucioneve profesionale, OJQ-ve dhe zyrave të ndryshme për të përmirësuar shërbimet për qytetarët;
- promovimi i shërbimeve dhe asistencës ndaj të moshuarve, fëmijëve dhe personave me paaftësi mendore, duke dhënë banesë dhe kushte të mira përmes institucioneve si: Shtëpia e të Moshuarve, Instituti i Shtimes dhe Shtëpitë Komunitare të ndryshme;
- promovimi i sistemit të komunikimit nëpërmjet zhvillimit të IT dhe realizimi i veprimtarive të formimit të personelit, me qëllim të krijimit të një administrimi profesional dhe të mjaftueshëm.

4.2 Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Në Janar 2009 bazuar mbi **Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17** si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet : Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunave, është bërë bartja e përgjegjësisë të menaxhimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga niveli qendror në atë lokal.

Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 potencon se “secila komunë, përmes drejtorisë së saj përkatëse, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria.

Këto shërbime sociale dhe familjare komuna i kryen përmes: “aktiviteteve të Qendrës për Punë Sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari”

Ky ligj i bën përgjegjëse komunat që të “marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Ato përgatisin plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajnë shënime e statistika siç specifikohet nga Departamenti, duke qenë të detyruara që t’i paraqesin atij raport për aktivitetet e tyre në fushë të shërbimeve sociale dhe familjare çdo vit, si dhe në çdo interval tjetër kohor, sipas kërkesës së

Departamentit. Në mënyrë që të promovohet përfshirja e komunitetit, transparenca dhe llogaridhënia, çdo drejtori publikon planin dhe raportin e tij vjetor.

Ligji mbi Shërbimet sociale dhe Familjare, komunave u njeh të drejtën e plotë për zhvillimin e shërbimeve shtesë duke u bazuar në natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre.

Qendra për Punë Sociale (QPS), është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale.

Kur një fëmijë braktiset ose mbetet pa kujdesin prindëror, QPS-ja e caktuar është përgjegjëse për marrjen në mbrojtje ligjore të fëmijës pa kujdes prindëror dhe vendosjes së tij nën kujdestari.

Organi i Kujdestarisë, sipas sistemit në veprim në Kosovë, ekziston brenda QPS-së, i cili është organ profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve, i përbërë nga një grup ekspertësh.

Menaxheri i rastit- Për çdo fëmijë caktohet një Menaxher i rastit- zyrtar brenda QPS-së, që është përgjegjës për menaxhimin e rastit të fëmijës, planin e përkujdesjes dhe vendosjen e formave alternative të mbrojtjes për fëmijën, i cili duhet të konsultohet edhe me profesionistë të tjerë në kuadër të QPS-së dhe sipas nevojës edhe me profesionistë jashtë QPS-së. Para marrjes së vendimeve të cilat do të ndikojnë në mirëqenien e fëmijës menaxheri duhet të konsultohet me kujdestarin ligjor të fëmijës.

Kujdestari ligjor: Kujdestaria ligjore e të miturit i përket një konsulenti tjetër të quajtur kujdestar ligjor i cili ka për obligim të kujdeset për t'i përfaqësuar të drejtat dhe interesat e fëmijës në mënyrë ligjore dhe për marrjen e vendimeve në interesin më të mirë për fëmijën. Ky Kujdestar emërohet nga Organi i Kujdestarisë nga radhët e zyrtarëve të shërbimeve sociale ose kur kjo është e mundur nga familja e fëmijës apo komuniteti.

4.3 QPS punon në bashkëpunim me Departamentin e Mirëqenies për të individualizuar zgjidhje të strehimit për fëmijët pa kujdes prindëror.

Ekzistojnë raste në të cilët prindërit nuk janë në gjendje të garantojnë kujdestarinë e fëmijëve të vet dhe si pasojë ata kalojnë nën kujdestarinë e shtetit. Përmbledhtazi, në Kosovë janë **1135 fëmijë** nën kujdestarinë QPS-ve, që nuk marrin kujdes të drejtpërdrejtë nga prindërit e tyre.

5. Format themelore të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror

Ligji Nr. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës - Përmes këtij ligji **Neni 7. Forma e mbrojtjes, pika 2.**

“Fëmijëve pa kujdes prindëror u sigurohet mbrojtja e posaçme përmes **formave të mbrojtjes** siç janë :

- ✓ kujdestaria,
- ✓ strehimi familjar,
- ✓ strehimi rezidencial dhe
- ✓ adoptimi

5.1 Gjendja aktuale e strehimit familjar në Kosovë

Strehimi familjar është një ndërhyrje e përkohshme ndihme dhe mbështetjeje për një fëmijë që vjen nga një familje e cila për momentin nuk është në gjendje të merret me nevojat e tij. Nëpërmjet strehimit, fëmija takon një familje që, duke e strehuar në shtëpinë e vet dhe në jetën e vet, përpiqet t’i sigurojë një përgjigje të përshtatshme për nevojat e tij afektive, edukative, të kujdesit dhe arsimimit në respektim të plotë të historisë së tij individuale dhe familjare.

Strehimi familjar karakterizohet nga disa veçanti

- Është një gjendje përkohshmërie. Kohëzgjatja varet nga tipi i vështirësive të pranishme në familjen e origjinës dhe kthimi i të miturit lidhet me kapërcimin e pengesave që e kanë krijuar nevojën.
- Mbajtja e marrëdhënieve me familjen e origjinës.
- Parashikimi i kthimit në familjen e origjinës ose në një familje adoptuese.

Në Kosovë ekzistojnë dy tipologji strehimi: me kohë të shkurtër (6 muaj maksimumi pritje), dhe me afat të gjatë- varësisht nga specifikat e secilit rast.

Sipas Udhëzuesit Administrativ, prindi strehues mund të jetë beqar, i martuar, bashkëjetues, ose i ve dhe në moshë më të madhe se 25 vjet. Kur ai është prind biologjik ose birësues, i mituri më i vogël duhet të ketë mbushur 2 vjeç për të mundësuar të përqendrojë energjitë e veta mbi të miturin në strehim. Kërkesa për strehuesin janë gjithashtu mungesa e detyrimeve të pazgjidhura dhe paraqitja e një vërtetimi të gjendjes gjyqësore. Familja strehuese duhet të tregojë të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të ketë kushte të përshtatshme për pritjen e fëmijëve.

Fatkeqësisht kjo pika e fundit nuk respektohet për pjesën më të madhe të rasteve: familjet strehuese që presin fëmijë në shumicën e rasteve nuk gëzojnë kushte të mira ekonomike. Vlerësimet e QPS nuk mbajnë parasysh realitetin dhe mbi të gjitha nuk mbajnë parasysh motivacionet reale të pranimi nga ana e familjeve që, edhe pse në kushte të pafavorshme, konsiderohen tërësisht drejt në marrjen e shpërblimit për pranimin e të miturve.

Familjeve që shprehin gatishmërinë për të pranuar fëmijë në strehim, QPS do të duhej t'u ofronin kurse formimi dhe përgatitje për strehimin dhe këshillime nga ana e specialistëve; prania e sektorit privat të OJQ që merren me një shërbim të tillë lehtësisht të kuptohet niveli i burimeve dhe kompetencës së publikut.

Është Paneli i Sistemit të Fëmijës që miraton përshtatshmërinë e një çifti strehues. Çdo vit familjet rivlerësohen nga operatorët e shërbimeve ndërsa çdo muaj do të kryhet një vizitë në shtëpi me vlerësime të shërbimit të strehimit të zhvilluar nga çifti.

Në momentin e pritjes të një fëmije, familja strehuese nënshkruan një kontratë me QPS në të cilën përcaktohen detyrimet në lidhje me fëmijën.

Kur strehimi ndodh brenda familjes së origjinës (strehim ndërfamiljar) kjo merr një shumë prej 75€ në muaj. Ekziston edhe një sistem strehimi familjar që ndodh jashtë rretheve familjare, duke përfshirë familje që nuk kanë asnjë lidhje me fëmijën (strehim familjar). Për fëmijën e vendosur në strehim familjar që është në gjendje të mirë shëndetësore Ministria ofron shumën prej 150 € në muaj ndërsa për fëmijët me nevoja të veçanta 250€ në muaj. Shumat e përmendura janë të destinuara për mbulimin e kostos së shpenzimeve të

fëmijës në strehim familjar kurse familja strehuese nuk kompensohet për këtë shërbim. Nuk regjistrohet një qëndrueshmëri në donacionin e linjave mujore nga ana e Ministrisë. Duke filluar nga viti 2013 linjat do të jenë në ngarkim të Komunave.

Periodha e përgatitjes dhe formimit të këtyre familjeve, në ngarkim të QPS-ve është rreth katër javë. Gjatë kësaj periudhe familjet shqyrtohen, intervistohen dhe instruktohen mbi rolin brenda shërbimit të strehimit familjar përveç çështjeve që i takojnë marrjes në ngarkim të miturve. Më pas në momentin e pritjes së fëmijës, familja mbetet në kontakt me operatorin e QPS përgjegjës për rastin dhe rrallë garanton vizita të rregullta mujore për shkak të ngarkesës edhe me raste të tjera të shumta sociale, aq më shumë në kushtet e mungesës së tmerrshme të mjeteve të transportit.

Fëmijët që nuk strehohen në strehim familjar apo ata që e kalojnë periudhën 2 vjeçare në familje strehuese të parashikuar nga ligji, dërgohen nga operatorët përgjegjës të rastit në qendra private komunitare të organizatave SOS Kinderdorf ose Shpresa&Shtëpitë e Fëmijëve ku veprojnë ekipe shumë-disiplinore që merren me fëmijët. Fëmijët me nevoja të veçanta janë të mirëpritur edhe në strehim familjar ose në shtëpitë e përhershme për fëmijë me aftësi të kufizuar të cilat janë në menaxhim direkt të Ministrisë, njëra ndodhet në Shtime dhe tjetra në Graçanicë. Këto dy qendra presin deri në 10 fëmijë dhe aktualisht në të dy qendrat ndodhen gjithsej 18 fëmijë. SOS Kinderdorf mund të presë 50 fëmijë ndërsa Shpresa&Shtëpitë e Fëmijëve mund të pranoi 12 prej tyre.

Periodhat e qëndrimit të fëmijëve brenda projekteve të tilla përcaktohen në gjashtë muaj/një vit, por një kufi i tillë shpesh kalohet kur nuk krijohen kushte për kthim në familje, kur nuk ka mundësi adoptimi ose operatorët përgjegjës nuk kujdesen për fëmijët kur pranohen në këto struktura private.

Në vijim të vitit 2011 janë përfunduar me ri-integrim në familjet biologjike 14 raste dhe me adoptim 25 raste. Për shkak të mbingarkesës së punës dhe të mungesës së mjeteve, jo gjithmonë operatorët e QPS arrijnë të garantojnë një monitorim të përshtatshëm të rasteve. Për disa raste vizitat respektojnë kohët e parashikuara në procedurë, ndërsa në rastet e tjera mungesa e mjeteve dhe fondeve për lëvizje nuk lejon një vëzhgim konstant. E denjë për t'u përmendur është mungesa brenda QPS-ve e figurës së psikologut: nuk ekziston një

profesionist (pavarësisht se në Kosovë ka burime të vlefshme) që të mbështesë fëmijën, familjen strehuese dhe familjen biologjike gjatë një momenti kaq delikat.

Bashkimi i të miturve me familjen biologjike, në fakt, shpesh është për shkak të mungesës së mundësisë alternative dhe jo për një projekt real individual strehimi të përpunuar për fëmijën. Këto raste do të duhej të ndiqeshin me vëmendjen më të madhe pasi shpesh kushti që çon në largimin e fëmijës nga familja, nuk zgjidhet në periudha të shkurtra në të cilat fëmijët janë larguar. Gjithashtu në ecurinë e viteve të punës me QPS del në pah një hezitim i operatorëve për heqjen e të drejtave prindërore pasi del të jetë shtojcë e lidhjes së gjakut para së gjithash, të jetë një mungesë sigurie e operatorëve kur do të duhej të merreshin zgjidhje përfundimtare mbi fëmijët. Një përcaktim më i qartë i kompetencave dhe roleve do ta lehtësonte ngarkesën e punës së operatorëve të QPS duke specifikuar përgjegjësitë që nuk mund të përzihen në një rol të vetëm.

Aspekte kritike

Duke dashur të përmbledhim fazat e një projekt strehimi me pika, listojmë aspektet kritike të dala në pah:

- **Numri i vogël i familjeve strehuese** –fond ky i cili nuk mbulon të gjitha komunat e Kosovës
- Nuk ekziston një fushatë sensibilizimi aktive në mënyrë periodike, dhe në shumë raste janë familjet ato që në mënyrë spontane parashtrojnë kërkesa pranë QPS për ofrimin e shërbimit të strehimit familjar, të nxitura nga familjet aktive strehuese.
- **Koordinimi:** Vështirësia për gjetjen e familjeve strehuese dhe ndonjëherë edhe një përgatitje e dobët dhe përzgjedhja e tyre duke u bazuar kryesisht mbi kriterin e të ardhurave dhe kushteve të banimit, gjë që nuk lejon në realitet mundësinë e një kombinimi të vërtetë midis familjes strehuese dhe të miturit, duke mos ndjekur kritere të vlerësimit efikas.
- Zakonisht për fëmijët e braktisur procedohet kërkimi i një burimi për vendosjen e fëmijës nisur nga familja e gjerë sipas shkallës së lidhjes familjare. Për të kërkuar më pas burime jashtë familjes. Nuk është hedhur asnjë

hipotezë që lejon të individualizohet burimi më i mirë për atë fëmijë, dhe nevojat e tij të veçanta, brenda një planifikimi të ndarë me të njëjtën (kur mosha e lejon) familje të origjinës, familja strehuese dhe vetë QPS.

- Strehimi, në disa raste, nuk shihet si një zgjidhje që i përgjigjet karakteristikës të përkohshmërisë të vendosjes. Kështu edhe përfshirja e punës me familjen e origjinës në projektin e strehimit familjar nuk është shpesh e parashikuar në strukturat e përgjithshme të projektit. Nuk janë të qarta se cilat lloje burimesh do të mund të ishin vendosur në vend për të mbështetur familjen e origjinës.
- Sa u tha me sipër, lidhet mirë me faktin që vlerësimi mbi kapacitetet prindërore bëhet zakonisht nga menaxheri i rastit, që nëse është e mundur, këshillohet me figura të tjera ekzistuese brenda shërbimit. Vetëm në disa raste kërkohen opinione të jashtme. Në realitet më shumë se një vlerësim i kapacitetit të mbetur hartohet një skedë social-anagrafike, dhe bëhet një vlerësim mjekësor, me përjashtim të rasteve në të cilët dyshohen keqtrajtime ose abuzime. Por figura e psikologut për vlerësime të tilla është plotësisht munguese. Në përgjithësi nuk është shumë i pranishëm në Kosovë, por QPS-të arrijnë të këshillohen me të vetëm kur gjenden fonde për të paguar këshillim të jashtëm.
- Familjet strehuese ankohen për një mungesë thelbësore të shërbimeve, mbi të gjitha në realizimin e administrimit të situatave me nevoja sanitare. Kjo nuk i përket vetëm kontributit të paktë të marrë, që shpesh nuk mjafton për të mbuluar as shpenzimet mjekësore, por edhe mbështetja edukuese dhe të specializuar nuk perceptohen si realisht mbështetëse.
- Nuk ekziston një praktikë e ndarë e strukturuar që të përcaktojë me qartësi rolin e politikës dhe të drejtorive komunale, përgjegjësitë dhe detyrimet. Decentralizimi nuk ka prodhuar akoma një rezultat të tillë, duke lënë në thelb një vakum institucional dhe operacional veprues, në të cilin iniciativa e individit dhe qëndrimi personal zëvendësohen me një protokoll ndërhyrje të çfarëdoshëm.
- Përfaqësuesit e popullatës serbe nuk janë çdoherë të pranishëm në trajnime dhe aktivitetet e ndryshme të organizuara dhe ky realitet nuk njihet i plotë nga QPS-të tjera. Gjithashtu duhet te ceket edhe për sa i përket

të dhënave statistikore lidhur me nevojat e fëmijëve, por edhe sa i përket metodave të ndërhyrjeve në situatat e vështirësive të ndryshme.

- Strehimi brenda-familjar duhet të ketë më shumë mbikëqyrje me plane të paraqitura nga ana e QPS-ve, me specifikimin e objektivave, por edhe në lidhje me dispozicionin e burimeve ekonomike e njerëzore.

Pas strehimit, adoptimi

Qëllimi i shërbimit të adoptimit është mbrojtja e mirëqenies afatgjatë të fëmijës, duke siguruar një sistemim të përhershëm në një familje në të cilën mbrohen të drejtat e fëmijëve.

Pjesa më e madhe e të miturve pa kujdes prindëror do të përfitonte nga sistemimi në një familje zëvendësuese me kompetencat dhe mundësitë për të plotësuar nevojat e tyre. Në këtë mënyrë, nevojat shoqërore, arsimimi dhe mirëqenia e një fëmije mund të përmbushen, si një anëtar i përhershëm i familjes. Shërbimi i adoptimit garanton bartjen e përhershme të të drejtave dhe përgjegjësiwe prindërore tek prindërit adoptues. Ligji mbi Familjen nr. 2004/32, dhe Ligji 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjen, përcakton se kur një fëmijë është jetim ose pa prindër, mund të jepet në kujdes përfundimtar për një familje me të cilën nuk ka lidhje gjaku. Është QPS-ja që mbulon procedurat e adoptimit për t'ia paraqitur familjen e përshtatshme për birësimin Panelit të Sistemimit të Fëmijës, ky i fundit me një procedurë administrative kryen bashkimin midis të fëmijëve në listë pritje për adoptim kombëtar dhe dosjeve të familjeve të përshtatshme në pritje. Zyrtarizimi i bashkimit ndodh nëpërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë dhe përgatitja e praktikave të adoptimit është në ngarkim të QPS-së.

Departamenti i Mirëqenies mban një regjistër unik të familjeve të përshtatshme për adoptim kombëtar. Prej muajit janar 2012 roli i Gjykatës është bërë i domosdoshëm për të mundur të procedohet me adoptimin qoftë kombëtar dhe ndërkombëtar; më parë dy ligjet ishin në fuqi në Kosovë, një që i përket legjislacionit jugosllav të vitit '84 ligji 011-2/84 mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare dhe atij që i përket periudhës së UNMIK-ut, Ligji mbi Familjen nr.2004/32. Bashkë-prania e sistemeve të tillë ligjore jo të qartë, ka bërë që

procedura e adoptimit qoftë kombëtar dhe ndërkombëtar, gjatë periudhës dhjetëvjeçare të jetë e tipit administrativ.

Sot, sipas legjislacionit në fuqi, familja e interesuar për adoptim të fëmijës pa kujdes prindëror, kërkesën duhet ta paraqesë në Gjykatë, ndërsa Gjykata kërkesën ia dërgon Qendrës për Punë Sociale për të dhënë vlerësimin profesional për familjen.

Pas vlerësimit profesional pozitiv QPS-ja e njofton me shkrim Gjykatën dhe familja evidentohet në Regjistrin për Panel të familjeve potenciale për adoptim.

QPS-ja para se të dërgojë lëndën në Gjykatë me propozimin për adoptim të fëmijës dhe familjes potenciale për adoptim, obligohet që paraprakisht të marrë mendimin e Panelit. Paneli mbikqyr respektimin e procedurave ligjore, konventave ndërkombëtare dhe procedurave profesionale nga ana e QPS-ve, në lëndën e fëmijës dhe të familjes të propozuar nga QPS-ja kompetente për rastin e fëmijës.

Pas marrjes së mendimit nga Paneli, QPS-ja kompetente për rastin e fëmijës së bashku me familjen potenciale për adoptim e bën iniciimin e procedurës pranë Gjykatës Komunale.

Gjykata Komunale shqyrton dosjen familjes e fëmijës potencial për adoptim dhe cakton periudhën provuese. Periudha provuese mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë që i siguron raport gjykatës sipas nevojës.

Adoptimi themelohet para Gjykatës sipas vendbanimit ku prindërit adoptues e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët apo para Gjykatës sipas vendbanimit të të adoptuarit.

Problemi që del është një ngathtësi e Gjykatave Komunale që nuk parashikojnë procedura të veçanta për adoptimin duke lënë fëmijën në pritje të një zgjidhje përfundimtare pa një afat kohor të dhënë nga ligji.

Kriticizmi i shfaqur është mungesa e përgatitjes të çiftit birësues kombëtar: QPS nuk ofrojnë një rrugëtim të pjekurisë së zgjedhjes së adoptimit dhe aq më tepër një udhëtim shoqërimi të çiftit gjatë pritjes.

Fëmijët e adoptuar në vitin 2009 kanë qenë 31, në 2010 kanë qenë 46, në 2011 kanë qenë 25.

Koha mesatare e pritjes të një çifti për adoptim kombëtar është 1 vit. Në dhjetor 2011 çiftet në listë pritje janë 101.

Konkludimet

Sistemi i strehimit në Kosovë rezulton i karakterizuar nga disa faktorë të veçantë të trajtuar më gjerësisht më sipër.

- Mikpritja e fëmijëve që jetojnë në gjendje vështirësie, ose të braktisur, jetim, së pari pritët në mënyrë natyrale nga familja e gjerë, akoma strukturë gjerësisht e organizuar parësore në shoqërinë kosovare.
- Sistemi i strehimit përfshihet, pra, në një kuadër të nënkuptuar nga një kombinim i një gatishmërie natyrale të pritjes nga ana e familjeve të gjera dhe të një mungese burimesh ekonomike e profesionale që lejojnë një ndërhyrje që mund të parandalojë dhe vendosë në plan të dytë urgjencën e vendosjes banuese të fëmijës, përkundrazi duke i dhënë përsëri rëndësi kujdestarisë ose mbrojtjes së fëmijërisë.
- Mundësia për të monitoruar gjendjen familjare në vështirësi, ose për të monitoruar mbi gjendjen e mirëqenies dhe mbrojtjen e fëmijërisë nuk është e strukturuar, aq më pak homogjene në zona të ndryshme gjeografike.
- Gatishmëria ekonomike dhe strukturore nga ana e Komunave, në favor të ndërhyrjeve të QPS-ve janë jo homogjene, e mbi të gjitha jo përherë veprimtaria e QPS-ve vlerësohet ndryshe nga një shërbim ndihmash dhe subvencionesh. Është theksuar shumë herë nga operatorët mungesa e vetëdijes politike dhe kulturore që ta inkadrojë ndërhyrjen sociale, mbi të gjitha për kujdestarinë e fëmijërisë, në një perspektivë që të shkojë tej asistencës, nevojës ekonomike dhe banimit.
- Në përcaktimin e Planeve të strehimit, të vlerësuar qoftë mbi rastet reale të sjella nga pjesëmarrësit, dhe nëpërmjet ushtrimeve të propozuara, rëndësia e fëmijëve, menduar si analizë dhe përcaktim i nevojave të tyre të qenësishme ose të lidhura me historinë personale të vetë atyre, nuk janë element themelor i planit të strehimit. Ka vëmendje për fëmijën, dhe vetëdije të botës së tij, por vështirësia për të gjetur burime të

nevojëshme për të strukturuar zgjedhje planifikuese të ndryshme janë refleksione në plan të dytë në lidhje me vendosjen, me urgjencën e ndërhyrjes humanitare dhe të emergjencës.

- Strehimi brenda-familjar nuk është kudo i regjistruar plotësisht; dhe akoma më shumë nuk është e qartë sa ky projekt do të jetë realisht projekt i mbikëqyrur nga ana e QPS-ve bazuar në objektiva, por edhe në lidhje me disponueshmërinë e burimeve ekonomike e njerëzore për këta fëmijë.

Rekomandimet

- Të fuqizohen Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes shtimit të burimeve njerëzore të përqendruara në mirëqenien sociale dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit.
- Planifikimi buxhetor vjetor të individualizojë burimet e nevojshme për praktikën vepruese të një projekti të Strehimit Familjar.
- Të standardizohet shërbimi i strehimit familjar.
- Të identifikohen protokollet e ndërhyrjes/vlerësimit unik në gjithë territorin kombëtar, që të mund të parashikojë vlerësime më të plota, e një veprimtari reale të Vëzhguesit Kombëtar mbi nevojat e fëmijëve dhe të familjeve në krizë.
- Të futen në Bazën e të Dhënave nga ana e QPS-ve, të gjitha rastet e strehimit si brenda familjes po ashtu edhe jashtë familjes dhe të monitorohen nga një Monitorues Kombëtar Qendror.
- Të fillojë një ndërhyrje edhe në komunat me shumicë serbe me qëllim përfshirjen e tyre në planin e zhvillimit të strehimit familjar.
- Të realizohen burimet e QPS-ve duke u nisur resurset e tyre, pra edhe strukturimi në ekupe regjionale me profesionistë dhe profesionalizëm që mund të ndërhyjnë në fazat e vlerësimit dhe mbikëqyrjes së planeve të rasteve të strehimit. Ekipet të cilat e bëjnë ndërhyrjen e tyre në realitetin e veçantë pa prishur parimet që rregullojnë Strehimin Familjar dhe veçantitë vendore, me praktikën e konsoliduar në kohë.

- Ekipet do të duhej të luanin një rol monitorimi të ndërhyrjeve në favor të fëmijëve duke kontribuar në hartimin e një Baze të Dhënash Kombëtare që të jetë në gjendje të dallojë brenda saj shkaqet, problematikat e përballura, ndërhyrjet e nevojshme, ndërhyrjet e kryera, dhe shpejtësinë e ndërhyrjes. Objektivi i këtij kërkimi do të duhej të jetë një vlerësim i kostove sociale të ndërhyrjeve në favor të fëmijërisë. Kostot lidhur me shpenzimin e kryer për QPS/ për orët e punës efektive të zhvilluara për këto ndërhyrje, me kostot e institucioneve të tjera të përfshira, kosto që familjet strehuese duhet të përballojnë, kontribute efektivisht të dhëna për to. E gjitha e financuar për të vlerësuar si një analizë më të mirë të rasteve.
- Të bëj analizë të nevojave dhe e shkaqeve në mënyrë që të zhvilloi politika parandalimi dhe ulje të fenomenit me qëllim që ky shpenzim të bëhet më pak i rëndë njerëzisht dhe ekonomikisht.
- Ndërhyrje formimi profesional për operatorët e QPS mbi temat e Strehimit, të nevojave të fëmijës, të analizës sociale dhe analiza klinike e rasteve.
- Të realizohen vizitat e rregullta dhe të bëhet mbikëqyrje e rasteve nga ana e QPS ve.
- Të bëhet rivlerësimi i familjeve strehuese, trajnimi i rregullt, por dhe sipas nevojës.
- Është e nevojshme jo vetëm një fushatë sensibilizimi për gjetjen e familjeve të gatshme për strehim familjar, por një fushatë homogjene në të gjithë territorin e Kosovës dhe që të jetë paralajmërim për ndërtim të një Rrjeti real familjesh strehuese.
- Të vlerësohen ndërhyrjet në favor të familjeve strehuese, jo vetëm nga pikëpamja ekonomike me qëllimin për t'i mbështetur në shpenzimet që duhet të përballojnë, por edhe ndërhyrjeve të mbështetjes profesionale, formuese që t'i japë përsëri një vlerë profesionale, dhe jo vetëm njerëzore, për ndërhyrjen e tyre.
- Të mirëmbahet Lista Familjeve Strehuese, me qëllim strukturimin e një rrjeti real që mund t'i përgjigjet në mënyrën më të gjerë nevojave të ndërhyrjeve të nevojshme, përtej Komunave prej nga janë. Ndërhyrjet më të

theksuara mbi nevojat e fëmijës dhe të Planit të strukturuar në favor të tij. Një rrjet i cili mund të ofrojë mbështetje qoftë nëpërmjet ndërhyrjeve profesionale të jashtme, dhe mbështetjeve të ndërsjella, në një stil vetë-ndihme reciproke.

- Rrjeti në komunitet do të mund të mbledhë edhe nevojat, vështirësitë që familjet përballin sot, me qëllim që të bëhen pjesë bashkëbisedimi dhe subjekt i planeve të strehimit familjar. Kurse ekipet në regione do të duhet të kenë detyrën për të vlerësuar burimet dhe nevojat në këtë drejtim.

AKRONIME

DMS-MPMS- Departamenti i Mireqenies Sociale, Ministria e Puneës dhe Mireqenies sociale

BPVja- Bruto Produkti Vendor - Agjencia e Statistikave të Kosovës

EJL- Evropa jug Lindore

SBF-Sondazhin mbi Buxhetin Familjar (SBF)

QPS/CSR- Qendra pËr PunË Sociale

UNMIK- United Mission in Kosovo

BIBLIOGRAFIA

Enti i Statistikave i Kosovës: Vlerësimi programatik i varfërisë në Ballkanin Perëndimor

Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009

“Economic Report Kosovo 2012-prill 2011
(John Hard, Better Childhood, UNicef 2012),
(Raporti vjetor 2008, 2009, 2010, nga DMS/MPMS

Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Ligji Nr. 2004/32. Ligji për Familjen i Kosovës

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17

Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare